




**HIDHE  
HAPIN**

# Hidhe Hapin

Integrimi i Grave Migrante të Brendshme



**Raport vlerësimi**

# Vlerësim i Projektit “Hidhe Hapin”

(Integrimi i grave migrante të brendshme)

---

## TABELA E PËRMBAJTJES:

### 1. VLERËSIMI I OBJEKTIVAVE

- 1.1 Objektivat afatshkurtra dhe afatgjata
- 1.2 Grupet përfituese

### 2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT

- 2.1 Zbatimi i projektit
- 2.1 Faza përgatitore
- 2.2 Shërbimet e siguruar

### 3. ECURIA E PROJEKTIT

- 3.1 Përmbledhja e aktiviteteve
- 3.2 Arritjet e projektit
- 3.3 Probleme të hasura
- 3.4 Mësime të nxjerra

Donator: HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane)



Shtator 2006

# **1. VLERËSIMI I OBJEKTIVAVE**

## **1.1 Objektivat afatgjata dhe afatshkurtra**

### **1.1.1 Objektivat afatgjata:**

Objektivi afatgjatë i këtij projekti ka qenë të promovojë integrimin e migranteve të brendshme femra, duke u dhënë atyre mundësi për formim profesional dhe trajnime të mëtejshme, me qëllim lehtësimin e procesit të punësimit në vendet ku ato jetojnë dhe për të kontribuar kështu sadopak për fuqizimin e grupeve vulnerabel dhe të mënjanuara në Shqipëri.

Synimi ynë ishte të ofronim një paketë të plotë integrimi për grupin përfitues që përfshinte integrimin profesional, social dhe kulturor.

Gjithashtu stafi i projektit synoi të ofronte këshillim, mbështetje emocionale dhe përfshirje të plotë në aktivitetet social-kulturore, të organizuara nga stafi i shoqatës.

Çka ne shpresojmë të bëjmë është të mbajmë kontakte të vazhdueshme edhe pas mbarimit të programit. Pjesa më e madhe e tyre do të punësohen në të njëjtën fushë që u trajnuan. Ne menduam se do të ishte mirë të vazhdojmë të ofrojmë informacion dhe këshillim sipas nevojave të këtij target grupi. Gjithashtu, shoqata jonë do të inkurajojë dhe mbështesë iniciativa nga persona apo grupe përfituesish që synojnë të vetëpunësohen. Kjo do të jetë një mbështetje në shkallë të vogël si p.sh. pajisja me vegla pune, mbështetje teknike dhe lehtësira të tjera të ngjashme. Ne do të përpiqemi të krijojmë një fond të vogël të posaçëm në mbështetje të këtyre grupeve përfituese.

Së fundmi, ky projekt i fokusuar tek gratë do të jetë një rrugë që do të na drejtojë drejt projekteve të mëtejshme në shërbim të komunitetit ku ne dëshirojmë të ndërhyjmë në një të ardhme jo të largët.

### **1.1.2 Objektivat afatshkurtra:**

#### **1. Trajnime Profesionale**

Duke iu adresuar nevojave të tyre, gratë do ta marrin këtë formim profesional në fusha të ndryshme. Ne synojmë që t'i pajisim ato me aftësi të reja, në mënyrë që të lehtësojmë dhe përshpejtojmë procesin e tyre të punësimit. Kjo do të bëhet në kurse të ndryshme të specializuara dhe në bashkëpunim me qendrat e trajnimit profesional, të cilat sigurojnë shërbime të tilla.

#### **2. Këshillim dhe mbështetje emocionale**

Seancat këshilluese do të zhvillohen me ato gra që kanë nevojë për mbështetje psikologjike dhe emocionale.

#### **3. Trajnime të tjera mbi problemet e grave**

Traget grupi i identifikuar, i përbërë nga gra dhe vajza të reja me nivel të ndryshëm arsimor, përballen me probleme të ndryshme të jetës së përditshme. Problemet dhe vështirësitë, me të cilat u duhet të përballen janë shumë më të mëdha se në jetën e qytetit. Për më tepër ka një mungesë informacioni dhe kulture për t'i kuptuar këto probleme. Ne e konsideruam të domosdoshme të ofrojmë disa seanca trajnime mbi shëndetin, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe problemet e higjienës, për arsye se rreziku i prekjes nga sëmundjet të tilla ishte i lartë.

## 1.2 Target grupi dhe përfitueset

- Migrantet e brendshme femra
- Gratë fshatare.

Vendndodhja: Fshati Laknas, 25 km larg nga Tirana.

Këto gra dhe vajza u organizuan në grupe dhe ndoqën kurse trajnimi në qendrat e formimit profesional nën mbështetjen dhe monitorimin e stafit të projektit "Hidhe Hapin". Seanca këshillimi, takime "Shtëpia e Hapur" dhe seanca trajnimi me tema të ndryshme u zhvilluan duke ia përshtatur sa më mirë nevojave të këtij grupi dhe duke synuar të zgjidhen problemet e tyre.

*Ato u shprehën që nuk kanë pasur më parë këshillime, mbështetje dhe ndihmë të këtij lloji për të kapërcyer problemet e jetës së tyre.*

## 2. SFONDI I PROJEKTIT

### - Zona e ndërhyrjes

### 2.1. Zbatimi i Projektit

Qysh prej vitit 1990 Shqipëria po përballlet me lëvizjen e madhe të popullsisë jashtë dhe brenda vendit. Masa e madhe e migrimit të popullsisë bën që të ketë një shpërbërje të sistemeve sociale fshatare dhe lidhjeve të ngushta familjare, të cilat para vitit 1990 ishin të forta, sepse udhëhiqeshin nga direktiva të forta paternaliste të shtetit që vepronin në mbarë popullatën.

Fluksi i madh i migrimit, paaftësia e shtetit për të siguruar banesa dhe infrastrukturë, mungesa e një plani urbanistik për të drejtuar zhvillimin, gjithashtu dhe situata e përgjithshme e anarkisë dhe trazirat çuan në zaptimin e tokave dhe ndërtimin e banesave në mënyrë të paligjshme nga të sapoardhurit. Të dhënat tregojnë se në vitin 1997 rreth 235.000 banorë (afro 50% e popullsisë së qytetit të Tiranës) banonin në zona me mungesë të theksuar infrastrukture dhe përdornin lidhje elektrike ilegale.

Popullsia migrante i përket një moshe relativisht të re, sepse zakonisht migrimi i brendshëm është një fenomen që prek më shumë moshat e reja. Gratë janë më shumë të predispozuar drejt migrimit të brendshëm se burrat. Megjithatë, dominimi i grave nuk është absolut për të gjitha moshat. Gratë e reja në fshat janë të detyruara të migrojnë edhe për arsye se ato nuk kanë të drejtë të trashëgojnë pronë nga familja. Gratë janë më të prirura të migrojnë, sepse mundësitë për punësim në sektorët e tretë janë më të shumta.

Të dhënat tregojnë se migrimi i popullsisë rural në zonat urbane nuk e ka ulur varfërinë, por ka kontribuar në zhvendosjen e varfërisë në zonat urbane.

Laknasi, është një zonë shumë e varfër me probleme të shumta sociale që vijnë nga varfëria, stereotipe të vjetra tradicionale të pabarazisë gjinore (gratë shpesh herë rrihen nga burrat), kultura të ndryshme; vajzat nuk lejohen të ndjekin shkollën për shkak të pasigurisë. Shërbimet shëndetësore lënë shumë për të dëshiruar. Ekziston gati një papunësi totale dhe jeta është e vështirë për banorët e kësaj zone. Gratë janë të angazhuara për t'ju përgjigjur të gjitha nevojave të familjes: fëmijëve, burrit, familjarëve të tjerë (ato ende jetojnë në stilin patriarkal- tre breza së bashku, shpesh herë 8-12 njerëz jetojnë nën të njëjtën çati prej 45-60 m<sup>2</sup>) në kushte shumë të mjerueshme. Marrëdhënia e vështirë që ato kanë brenda familjes është për shkak të agresivitetit të burrave (duke mos punuar, ata bëhen agresivë). Shpesh gratë e pamartuara ose vejushat bëhen barrë për mendjet e tyre.

Shumë familje u shpërngulën në zona të tilla pa patur asgjë dhe u përballën me vështirësi të shumta në ndërtimin e një vendi për të jetuar. Normalisht, familjet janë grupuar sipas origjinës së vendit nga vijnë ose sipas lidhjeve familjare: shumica më e madhe vijnë nga Kukësi, megjithëse ka një numër të madh të të ardhurve edhe nga Tropoja, Puka, Mirdita dhe më pak nga zonat e jugut të vendit.

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia e Kamzës, popullsia e zonës së Laknasit në fund të vitit 2005 ishte 7885 banorë, ndër to 4019 ishin meshkuj dhe 3866 femra.

Numri i familjeve që banonin në atë zonë ishte 1311.

## **VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT**

### **2.1.1. Faza përgatitore**

#### **➤ Informacioni**

Në fazën fillestare të projektit u mbledh një informacion i gjerë për zonat ku janë përqëndruar migrantët e brendshëm. Ky informacion është mbledhur falë vizitave që janë bërë në rrethinat e Tiranës dhe zonave të tjera ku janë zhvilluar takime me banues të këtyre zonave. Është mbledhur informacion nëpërmjet Internetit nga stafi i projektit si edhe nga përfituesit tanë të mëparshëm që jetojnë në këto zona. Synimi ynë ishte ta zhvillonim këtë projekt në një zonë të paprekur më parë nga OJF të tjera.

#### **➤ Publiciteti për projektin**

Për të zhvilluar projektin, në zonat ku ne kishim interes u shpërndanë fletëpalosje me informacion mbi projektin "Hidhe Hapin" dhe Shoqatën "Shpresë për të Ardhmen". Gjithashtu, u shpërndanë fletushka që ftonin gratë dhe vajzat për të marrë pjesë në këtë program. Ne vendosëm ta zhvillojmë këtë projekt në Laknas, për arsye se patëm atje mbështetjen e përfituesve tanë që jetojnë dhe punojnë në këtë fshat. Njëri nga përfituesit ishte emëruar nëndrejtor i shkollës tetëvjeçare të Laknasit. Ai na ofroi gjithë mbështetjen e tij për të organizuar takime me prindërit e fëmijëve dhe duke shpërndarë materialet sensibilizuese.

#### **➤ Identifikimi i partnerëve dhe firmosja e marrëveshjeve dypalëshe**

Ka qenë në interes të përbashkët dhe në të mirë të projektit vendosja e marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me qeverinë vendore. Me kërkesën e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" u mundësua një takim me kryetarin dhe nënkryetarin e Bashkisë Kamëz. Takimi synoi në mbledhjen e informacionit dhe shifrave mbi popullsinë e Laknasit dhe situatën në atë zonë, për të identifikuar problemet dhe nevojat kryesore me qëllim përcaktimin e ndërhyrjes. Në mësuam se numri i papunësisë të gratë ishte në nivel shumë të lartë. Shumica e tyre kishin arsim të ulët dhe nuk kishin pasur asnjë mundësi për trajnime profesionale në zonën ku banojnë. Ekziston një infrastrukturë e varfër gjë që e bën më të vështirë jetën e tyre.

Ne zhvilluam një sërë takimesh në Bashkinë e Kamzës me qëllim prezantimin e OJF-së sonë dhe projekteve të planifikuara nga ne, shpallëm idetë tona për të ndërhyrë në zonën e Laknasit. Na u desh një kohë e gjatë për t'i bindur që ky projekt për gratë të zhvillohej, pasi ata ishin skeptikë dhe me paragjykime për OJF-të në përgjithësi.

Dy muaj më vonë ne morëm një letër falenderimi nga bashkia për punën e shkëlqyer që po bëmë me gratë dhe familjet e tyre në zonën e Laknasit.

Në kuadrin e bashkëpunimit me Bashkinë e Kamzës, Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" pati mundësinë t'i bashkohej rrjetit të OJF-ve që operojnë në zonën e Kamzës. Shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencës, bashkërendimi i veprimeve për të përmirësuar nevojat e komunitetit kanë qenë në fokus të këtyre takimeve.

"Shpresë për të Ardhmen" negocioi me subjekte si Drejtoria Rajonale e Punësimit në Tiranë (Shpresë për të Ardhmen ka nënshkruar marrëveshje me këtë institucion publik) dhe Qendrën Publike të Trajnimit Profesional nr.4). Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ne patëm mundësi të ofronim për përfituesit e projekteve trajnime në këto qendra profesionale trajnime publike me çmime shumë më të ulta se ato private. Kjo marrëveshje na dha gjithashtu mundësi për të bashkërenduar veprimet dhe shërbimet në drejtëm të përfituesve. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, ishte gjithashtu sigurimi i një vendi pune për gratë pas mbarimit të kurseve të rrobaqepësisë, kompjuterit dhe gjuhëve të huaja.

Në lidhje me kurset e kuzhinës dhe parukerisë ne i bëmë një kërkesë Shoqatës "Në Dobi të Gruas Shqiptare" dhe gjetëm mirëkuptimin e tyre për sistemimin e disa grave dhe vajzave në kurset që ofron Qendra "Alternative Profesionale".

Në mbarim të kurseve Shoqata i referoi përfitueset të Zyrat e Punësimit në Tiranë për t'i regjistruar si të papuna dhe për të gjetur mundësi punësimi në përputhje me arsimimin dhe aftësitë profesionale që përfituan nga kurset.

Në vijim të bashkëpunimit me aktorë të tjerë Shpresë për të Ardhmen ka bërë një sërë takimesh me Medica Mondiale Tirana, e cila është një qendër e specializuar për shërbime të mbështjetjes psiko-sociale dhe mjekësore për gratë dhe vajzat e stresuara. Shoqata ka organizuar trajnime mbi parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme me specialiste nga kjo qendër. Gratë me probleme shëndetësore, shumicën e rasteve të sëmura me SST janë drejtuar te kjo qendër për të marrë shërbim të specializuar pa pagesë.

### ➤ **Identifikimi i grave migrante të brëndshme dhe shpërndarja e informacionit për projektin**

Për identifikimin e përfitueseve të mundshme në Projektin "Hidhe Hapin", Shpresë për të Ardhmen ndërmoi disa hapa. Në fillim shoqata kontaktoi me drejtorin dhe zv.drejtorin (ish përfitues i Projektit "Kape të Ardhmen") të shkollës tetëvjeçare të Laknasit për të prezantuar synimin kryesor të projektit dhe përfitimet që komuniteti do të kishte nga shërbime të tilla. Me mbështetjen e zv.drejtorit të shkollës, ne mundësuam organizimin e disa takimeve me mësues dhe prindër të fëmijëve, me të cilët diskutuam nevojën e projektit për komunitetin dhe ndikimin pozitiv të tij te grupe të veçanta dhe komuniteti në përgjithësi. Ata e konsideruan projektin tonë shumë të dobishëm dhe të domosdoshëm sidomos për gratë, të cilat janë një grup vulnerabel i komunitetit dhe kanë nevojë për shërbime të tilla si arsimim, trajnime profesionale dhe shërbime sociale. Stafi i "Shpresë për të Ardhmen" së bashku me mësues të shkollës u shpërndanë fletëpalosje dhe pyetësorë grave gjatë kohës që ato shoqëronin fëmijët në shkollë dhe nëpërmjet takimeve që mësuesit patën me familjarët e fëmijëve. Ishte shumë dobiprurëse të përdorje mjediset e shkollës për të kontaktuar me gratë dhe dhënë informacione në lidhje me projektin, pasi ato mjedise ishin shumë të frekuentuara nga fshatarët e zonës.

Disa nga rastet na u referuan nga Bashkia e Kamzës, pasi kishte gra që jetonin në kushte të mjerueshme, me nivel të pakët arsimimi, dhe eksperiencë pune të pamjaftueshme. Në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz, shoqata i përzgjedhi këto gra si të përshtatshme për të ndjekur kurse rrobaqepësie dhe kuzhine.

Gjithashtu, ne kërkuam mbështetje edhe nga kryeplaku i zonës së Laknasit duke e konsideruar atë si person shumë të besueshëm në komunitet. Nëpërmjet mbështetjes së tij ne mundëm të identifikonim përfitues të mundshëm. Në këtë mënyrë gratë treguan më shumë interes për ndihmën tonë dhe familjet e tyre, burrat ose vëllezërit, ishin më pak skeptikë për shërbimet tona.

Kjo ishte një mbështetje shumë e veçantë që iu bë shoqatës, për arsye se në këtë mënyrë ne patëm mundësi të njihnim më në thellësi problemet e këtij komuniteti dhe të siguronim asistencën e duhur.

Një tjetër ndihmë na është dhënë edhe nga dy ish përfitues të Projektit tonë kryesor "Kape të Ardhmen" që jetojnë në zonën e Laknasit. Ata dhanë eksperiencën e tyre pozitive të fituar gjatë pjesëmarrjes në programin riintegruar të Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" dhe i nxitën pjesëmarrëset të thyenin akullin dhe të bashkoheshin me njëra-tjetrën në këtë projekt. *Prania e tyre ishte shembulli më i mirë për t'i treguar njerëzve në Laknas që Shpresë për të Ardhmen siguron shërbime të besueshme dhe të suksesshme.*

Pas kontaktimit dhe plotësimit të pyetësorëve nga një numër i konsiderueshëm i grave të zonës, Shpresë për të Ardhmen organizoi katër takime "Shtëpia e Hapur" me gratë e Laknasit dhe diskutoi për nevojat e tyre të përbashkëta, problemet, planet për të ardhmen, situatën e tyre ekonomike në familje, nivelin e papunësisë dhe mundësitë ekzistuese për t'u punësuar në këtë zonë.

Hapi tjetër ishte përzgjedhja e grave përfituese potenciale që përmbushnin kriteret e projektit: mosha 17-40 vjeç, kushte të varfra ekonomike, arsimim të ulët dhe moszotërimi i ndonjë profesioni.

Pas kësaj punonjësisë sociale të Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" bënë intervista individuale me secilën nga gratë e përzgjedhura, në mënyrë që të identifikonin nevojat e tyre, statusin social, prioritetet e tyre dhe disa mënyra për t'i zgjidhur këto probleme duke u fokusuar në vendimmarrjen individuale të secilës prej tyre.

U plotësua dokumentacioni i nevojshëm me të dhënat personale dhe u krijua një dosje e veçantë për çdo përfituese.

## 2.1.2. Shërbimet e ofruara

### ➤ Këshillimi

Grave përfituese të projektit iu siguroa mbështetja psiko-sociale e kërkuar. Shëndeti i mirë është një gjendje ku përfshihen mirëqenia fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesa e sëmundjeve dhe pafuqia. Ky postulat u pat parasysh nga ofruesit e shërbimit.

Mbështetje psiko-sociale iu ofrua grave, në përshtatje me nevojat dhe atributet të veçanta të situatës, duke i ndihmuar ato në pranimin e situatës dhe duke dhënë rrugëzgjdhje për përmirësimin e saj.

Këshillim është ofruar në rastet e braktisjes së shkollës, problemeve shëndetësore, dhunës familjare, situatës së tregut të punës etj.

Këshillime individuale dhe këshillime në grup janë zhvilluar kryesisht në zyrat e shoqatës. Në raste të veçanta ne kemi ofruar këshillim familjar sidomos në rastet të problemeve gjinore, ndarjes së detyrimeve familjare etj.

Këtu e shohim të rëndësishme të përmendim dy nga rastet e ndjekura:

Ne patëm dy vajza të reja 18 vjeçare që kishin braktisur shkollën për shkak të presionit të familjes. Familjet e tyre vinin nga zona fshatare të Veriut të Shqipërisë. Pas mbarimit të shkollës fillore, bazuar në mentalitetin patriarkal dhe të prapambetur të trajtimit të femrës, familjet nuk i lejojnë vajzat të vazhdojnë shkollën më tej. Sipas prindërve, mosha e mbarimit të shkollës fillore konsiderohet si "mosha e martesës" dhe vajzat e kësaj moshe nuk është mirë të dalin nga shtëpia. Ky është një problem ende i madh i mentalitetit të vjetër shqiptar në zonat rurale.

Me qëllim ndjekjen dhe përmirësimin e situatës së përfituesve të programit, stafi i Shpresë për të Ardhmen bëri vizita në shtëpitë e vajzave, u takua me prindërit e tyre dhe familjarët e tjerë dhe diskutoi me ta këtë problem. Ne i bëmë të ditur atyre rëndësinë e madhe të arsimit, si mund të jetë e ardhmja e vajzave pa arsim dhe të gjithë situatën që ka të bëjë me arsimin individual. Stafi i Shpresë për të Ardhmen bëri disa vizita të tjera edhe në familjet që kanë lidhje fisnore me familjet e vajzave dhe deri tani ne kemi arritur të bindim njërin nga familjet e vajzave që ta lejojë atë të ndjekë shkollën. Përpjekjet tona për të bindur familjen tjetër nuk kanë mbaruar. Ne jemi në kontakt me prindërit e vajzës dhe shumë shpejt do të bëjmë një vizitë tjetër në shtëpinë e tyre. Ajo çfarë ne vëmë re tani është që prindërit e vajzës nuk janë më aq të ashpër dhe të vendosur sa ishin në takimin tonë të parë. Fillimi i vitit të ri akademik do të na tregojë më konkretisht rezultatet e punës sonë me këto familje.

### ➤ Formimi profesional

Përfituesve të projektit "Hidhe Hapin" u është siguar:

#### - **Kurs rrobaqepësie**

16 gra kanë përfituar kurs profesional rrobaqepësie.

Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit në Tiranë u mundësua sistemimi i grupit të shënjestruar nga ne në kurse rrobaqepësie pranë qendrës profesionale Nr. 4.

*Nëse e ke pasion qepjen, do të habitesh edhe vetë se ç'mund të bëjë teknika e qepjes për përmirësimin e veshjeve të tua.*

Në këtë kontekst, grupi i grave që ne përzgjedhëm për të ndjekur kursin e rrobaqepësisë ishin gra që kishin dëshirë të qepnin, të gatshme për të mësuar dhe me një vizion për qepjen. Duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e aplikanteve ishin të interesuara për këtë kurs. Ne u siguroam përfituesve tona materiale ndihmëse për mësimin e rrobaqepësisë dhe praktikimin e teknikave si copa të llojeve të ndryshme, metër, gjilpëra, rrota penjsh, zinxhirë etj.

#### - **Kurs kompjuteri**

13 gra përfituan kurs kompjuteri.

Ky grup kursantesh u përbë nga gra që kishin të paktën diplomën e shkollës së mesme dhe kishin nevojë për një kurs kompjuteri për të përmirësuar aftësitë e tyre profesionale. Ne identifikuam dy raste të grave që kishin mbaruar Fakultetin Ekonomik dhe kishin vështirësi për të gjetur punë pa patur njohuri kompjuteri. Ky kurs u ofrua gjithashtu nga Qendra Profesionale Nr.4.

### **- Kurs parukerie**

7 gra përfituan kurse profesionale parukerie. Kursi u ofrua nga Qendra "Alternativa Profesionale", e Shoqatës "Në Dobi të Gruas Shqiptare", diploma e të cilës njihet nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Ky kurs zgjati 3 muaj. Të 7 gratë e mbaruan kursin tremujor me rezultate të mira. Pesë më të mirat përfituan një kurs njëmuajor estetike.

### **- Kurs kuzhine**

7 gra ndoqën kurse profesionale të kuzhinës. Edhe ky kurs u ofrua nga Qendra "Alternativa Profesionale". Ai zgjati 3 muaj dhe u bazua në teknikat dhe metodat bazë të gatimit, të cilat mund të përdoren në një kuzhinë profesionale ose në shtëpi. Në këtë kurs pati një kombinim të mirë të teorisë me praktikën.

### **- Kurs i gjuhës angleze**

7 persona ndoqën kursin e gjuhës angleze.

Grupi i përfitueseve që ndoqën kursin e gjuhës angleze përbëhej nga vajza të reja që kishin mbaruar shkollën e mesme dhe kishin dëshirë të vazhdonin universitetin dhe një grua që kish mbaruar studimet universitare dhe i duhej gjuha angleze për të gjetur një punë më të mirë.

## **Trajnimi**

Sikundër ishte parashikuar, në Projektin "Hidhe Hapin" u zhvilluan këto sesione trajnime me temë:

- Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST)
- Dhuna në familje dhe rolet e gjinisë
- Aftësitë prezantuese në një intervistë pune.

## **Trajnimet mbi "Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST)"**

Për mentalitetin e mbyllur të grupit që ne mbështesim, një problem seksual konsiderohet tabu. Gratë ngurrojnë të marrin informacionin e nevojshëm në këtë fushë. Mungesa e informacionit dhe njohurive e vë shëndetin e tyre në rrezik. Kjo është arsyeja kryesore pse ne vendosëm ta trajtonim këtë temë. Trajnimi u organizua në bashkëpunim me Medica Mondiale (Tiranë), qendër terapie për gratë, e cila na mbështeti me praktikë gjinekologjike, mbështetje psikologjike dhe përkujdesje mjekësore.

### **Temat e diskutuara:**

- Çfarë është një sëmundje seksualisht e transmetueshme (SST)?
- Si mund të marrim një SST?
- Cilat janë simptomat e SST?
- Si të testohem për një SST?
- Si ta kuroj një SST?
- Çfarë mund të bëj për të evituar marrjen e një SST?

### **TRAJNIM MBI "DHUNA NË FAMILJE DHE PROBLEMET E GJINIVE"**

Dhuna në familje është një problem shumë i përhapur që prek të gjitha moshat, gjinitë, racat, formimet arsimore dhe grupet socialo-ekonomike. Megjithatë gratë dhe fëmijët janë grupet më shumë të prekura nga ky fenomen. Duke qenë se janë më pak të arsimuara dhe shtëpiake, gratë rrezikojnë të dhunohen dhe të vuajnë pabarazinë gjinore.

### **Temat e diskutuara në trajnim ishin:**

- Çfarë është dhuna familjare?
- Format e dhunës
- Gratë e dhunuara dhe fizionomia e burrave
- Faza e dhunës
- Çfarë është gjinia?
- Diskriminimi gjinor
- Barazia gjinore
- Luajtje rolesh mbi dhunën familjare dhe problemet gjinore.

### **TRAJNIM MBI "AFTËSITË PËR T'U VETËPREZANTUAR NË NJË INTERVISTË PUNE"**

Trajnimi i zhvilluar u dha mundësi përfitueseve të mësojnë elementët kryesorë që nevojiten për të patur sukses gjatë një interviste pune. Kështu, u diskutua mbi:

- Si të japim një intervistë të suksesshme pune (aftësitë kryesore, trajnim për sjelljen);
- Si të shkruajmë një CV;
- Ndërveprimi dhe bashkëpunimi midis grave.

### **Aktivitetet sociale**

Takimet "Shtëpia e Hapur" janë organizuar çdo muaj. Këto takime i kanë ndihmuar përfitueset tona të takojnë dhe njohin njëra-tjetrën më mirë, të shkëmbejnë eksperiencat dhe të diskutojnë situatat e jetës së tyre. Përveç këtyre janë organizuar edhe takime tematike ku ndërmjet të tjerash është diskutuar:

- Të zbulosh kush je
- Vendimmarrja dhe vlerat
- Komunikimi me të tjerët
- Ndryshimi i stilit të jetës
- Përkujdesja për fëmijët etj.

### **Aktivitete të tjera të kohës së lirë**

Aktivitetet gjatë kohës së lirë janë një mundësi për t'u dëfryer dhe ndihmojnë integrimin e grave në jetën sociale dhe kulturore. Aktivitete të tilla janë ndërmjet të tjerash:

Vizitë në Qytetin e Krujës, vajtje në kinema apo teatër, vizitë në panairë të ndryshme etj.

### 3.1. Përmbledhje e Aktiviteteve

No.	Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kohëzgjatja e aktivitetit
1	Publiciteti i Projektit		
	Shpërndarja e fletëpalosjeve të projektit "Hidhe Hapin" dhe i pyetësorëve	Koordinator i projektit dhe stafi i projektit	Janar 2006
	Takime në zonën rurale të Laknasit për të dhënë informacion rreth projektit	Koordinator i projektit dhe stafi i projektit	Janar 2006
2	Faza përgatitore		
	Identifikimi i grave migrante të brendshme dhe shpërndarja e informacionit për projektin	Stafi i projektit	
	Drejtori i Shkollës Tetëvjeçare të Laknasit		Janar 2006
	Komuna e Kamzës	Koordinator i projektit dhe punonjësi i marrëdhënieve me publikun	Janar 2006
	Takime me kryeplakun e fshatit Laknas	Koordinatori i projektit dhe punonjësi social	Janar 2006
	Ish klientët e projektit "Kape"	Stafi i projektit	Janar, Shkurt 2006
	Identifikimi i partnerëve dhe nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe.		
	Komuna e Kamzës	Koordinatori i projektit	Janar 2006
	Rrjeti NPO i zonës së Kamzës	Punonjësi i marrëdhënieve me publikun	Shkurt 2006
	Zyra Rajonale e Punësimit, Tiranë -Qendra Profesionale No.4	Koordinatori i projektit	Shkurt 2006
	Qendra Alternativë Profesionale		Mars 2006
	Medica Mondiale	Koordinatori i projektit	Prill 2006
3	Kurse Profesionale		
	Kurs rrobaqepësie (16 gra)	Qendra Profesionale Nr.4	Shkurt 2006 dhe më tej
	Kurs kuzhine (7 gra)	Qendra Alternativë Profesionale	Mars 2006 dhe më tej
	Kurs parukerie (7 gra)	Qendra Alternativë Profesionale	Mars 2006 dhe më tej
	Kurs Kompjuteri (13 gra)	Qendra Profesionale No.4 Qendra Wisdom Qendra Universe	Shkurt 2006 dhe më tej
	Kurs i gjuhës angleze (7 gra)	Qendra Universe Qendra Wisdom	Shkurt 2006 dhe më tej
4	Monitorimi		
	Vizitat në Qendrat Profesionale	Koordinatori i Projektit dhe punonjësi social	Një herë në javë
5	Trajnimet		
	Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST)	Medica Mondiale	Prill 2006
	Dhuna në familje dhe problemet e gjinive	Medica Mondiale	Qershor 2006
	Vetë prezantimi i njohurive në një intervistë pune	Fondacioni Soros	Shtator 2006
6	Aktivitetet Sociale		
	Takime "Shtëpia e Hapur"	Punonjësit social	Një herë në muaj
7	Aktivitete të kohës së lirë		
	Panairi i pranverës për prodhimet shtëpiake	Stafi i projektit	Prill 2006
	Vajtje në teatër	Stafi i projektit	Qershor 2006
	Vajtje në kinema	Stafi i projektit	Gusht 2006
	Vizitë në Krujë	Stafi i projektit	Shtator 2006

### **3.2 Arritjet e projektit**

Trajnimet profesionale

#### ***Kurs i rrobaqepësisë***

16 gra përfunduan me sukses kursin 4 mujor të rrobaqepësisë. 12 prej tyre u punësuan pas përfundimit të kursit. 2 u vetëpunësuan dhe 10 prej tyre gjetën punë në një biznes privat. Punësimi i tyre u realizua gjatë zhvillimit të projektit "Hidhe Hapin".

#### ***Kursi i parukerisë***

7 gra përfunduan kursin 3 mujor të parukerisë. 5 prej tyre u kualifikuan me rezultate shumë të mira dhe shprehën dëshirën për të thelluar njohuritë e tyre në këtë fushë. Projekti "Hidhe Hapin" u siguroi atyre një muaj kurs estetike më tepër. Për shkak të pushimeve verore kursi i estetikës u ndërpre në Qershor dhe rifilloi në Shtator. Të 5 gratë janë duke e ndjekur rregullisht kursin dhe vlerësojnë përfitimet e marra nga ky kurs. Aktualisht, 2 prej grave që mbaruan kursin 3 mujor janë në kërkim të një vendi pune. Projekti "Hidhe Hapin" është duke kërkuar vende pune për 2 gratë e papunësuara ende.

#### ***Kursi i kuzhinës***

5 gra përfunduan me sukses kursin 3 mujor të kuzhinës. Të gjitha ato vlerësojnë njohuritë e marra në artin e kulinarisë. Deri tani 2 prej tyre janë punësuar pas mbarimit të kursit. Njëra është punësuar në një furrë buke dhe tjetra në dyqan ëmbëlsirash. 2 gra janë ende duke ndjekur kursin e kuzhinës.

#### ***Kurs Kompjuteri***

9 gra përfunduan kursin 2 mujor të kompjuterit. Arritjet e tyre janë për t'u admiruar. 6 nga këto gra mund të punësohen me ndërhyrjen tonë. 4 gra të tjera janë ende duke vazhduar kursin i cili përfundon në fund të Shtatorit, ngaqë gjatë kohës së verës shumica e qendrave jopublike janë të mbyllura dhe hapin në Shtator.

#### ***Kurs i gjuhës angleze***

Deri tani 3 gra kanë përfunduar kursin 4 mujor të gjuhës angleze. 2 prej tyre u punësuan pas mbarimit të kursit. 4 të tjera janë ende duke vazhduar atë. Kursi i tyre mbaron në fund të Tetorit.

*Në përfundim, deri në fund të Gushtit 2006, 35 gra përfunduan kurse të formimit profesional. 22 nga 35 prej tyre janë pothuajse të punësuara që do të thotë 62% e tyre.*

#### ***Çfarë mendojnë përfitueset për aktivitetet sociale dhe ato të kohës së lirë?***

Përprojekjet për të ndihmuar në integrimin e grave migrante të brendshme duhet të mbështeten në besimin që integrimi është i mundur për të gjitha grupet. Nisur nga ky parim këto lloj aktivitetesh kanë gjetur mbështetjen dhe pjesëmarrjen e duhur nga gratë, të cilat e kanë kuptuar më së miri dobinë e tyre. Aktivitetet sociale dhe ato të kohës së lirë shërbyen për të argëtuar, qetësuar dhe miqësuar gratë, të cilat kishin interesa të përbashkëta.

Gratë u ndjenë të ndryshuara, madje edhe në pamjen e jashtme.

Vajtja në kinema ose në teatër ishte një eksperiencë e re për pjesën më të madhe të përfitueseve tona, të cilat jeta në fshat pothuajse i përjashton fare nga jeta sociale dhe aktivitetet kulturore. Ato u ndjenë të lumtura dhe entuziaste. Këto aktivitete u dhanë atyre një mundësi për të njohur dhe shijuar një tjetër pjesë të jetës që nuk kishin patur mundësi për ta provuar më parë.

#### ***Cili është mendimi i përfitueseve të projektit në lidhje me realizimin e trajnimeve?***

Përfitueset e projektit vlerësuan në mënyrë të veçantë kurset e realizuara në bazë të nevojave të tyre. Ato u ndjenë të përkrahura nga ne dhe e pane që problemet e tyre janë adresuar. Në fund ato thanë që ndryshimet e bëra me ndihmën e projektit "Hidhe Hapin" kanë përmirësuar statusin e tyre të përgjithshëm: shëndetin fizik dhe atë psikologjik.

*Puna me këto gra është një proces që nuk mund të mbarojë për një javë ose një muaj. Por ne mendojmë se kemi mundur shërbime të mira për to dhe me kalimin e kohës ne do të shohim më shumë rezultate konkrete në punën e bërë me to.*

### 3.3. Problemet e hasura

Shpresë për të Ardhmen gjatë zhvillimit të projektit "Hidhe Hapin" hasi shumë vështirësi dhe pengesa në faza të ndryshme të projektit. Punë e vështirë ka qenë krijimi i konfidencës dhe besimit midis stafit të shoqatës dhe grave. Ato nuk kishin asnjë informacion për aktivitetet e Shpresë për të Ardhmen dhe për më tepër asnjë OJF nuk kishte operuar më parë në atë komunitet.

Nuk ishte e lehtë t'i bindje gratë të ndiqnin kurse profesionale jashtë shtëpisë, për arsye se ato ishin mësuar të bënin një jetë prej shtëpiakeje, duke u marrë gjatë gjithë kohës me rritjen e fëmijëve dhe punët e shtëpisë. Disa nga gratë ishin vendosur në zonën e Laknasit vetëm një vit më parë, kështu që për to integrimi në ambientin e ri social dhe ekonomik ka qenë tepër i vështirë.

Ne bëmë të gjitha përpjekjet tona për të ndryshuar mentalitetin patriarkal që dominon në fshat. Gratë duhet të kenë lehtë nga burrat, baballarët ose vëllezërit e tyre për të bërë një hap për para në jetën e tyre, për t'u larguar nga shtëpia, për të vazhduar shkollën ose ndjekur kurse profesionale.

Transporti i grave ishte një problem tjetër. Nuk ka transport publik nga Laknasi në Tiranë, kështu që Shpresë për të Ardhmen pajtoi dy mikrobusë për shoqërimin e grave në qendrat profesionale të trajnimit në Tiranë. Infrastruktura rrugore është në kushte shumë të vështira, kështu në kohë të keqe ka qenë e vështirë edhe për stafin e shoqatës për të shkuar në atë zonë.

Takimet e para organizuar nga Shpresë për të Ardhmen ishin më pak të frekuentuara për arsyet e sipërpërmendura. Në disa raste gratë janë shoqëruar nga burrat ose të afërmit e tyre. Pjesëmarrja e tyre nuk ka qenë aktive në këto takime dhe ato nuk ishin të sigurta në duhej apo jo t'i pranonin shërbimet e shoqatës.

Në fillim të projektit ka qenë e vështirë për të ndërtuar konfidencë dhe mirëbesim edhe me përfaqësuesit kryesorë të Bashkisë Kamëz. Kjo ishte e domosdoshme të krijohej, për arsye se ne kishim nevojë për mbështetjen e tyre. Për këtë na u desh të zhvillonim disa takime me organizmat publike dhe të bënim një prezantim të detajuar të shërbimeve të shoqatës sonë dhe punën e bërë gjatë viteve.

Një vështirësi tjetër që hasëm ishte mungesa e mjeteve të punës në kurset publike të rrobaqepësisë, kështu që na u desh të pajisnim qendrën e trajnimit me të gjitha materialet e duhura.

Çmimet e kurseve të parukerisë dhe kuzhinës ishin më të larta nga çfarë kishim parashikuar ne (mbi 70.000 lekë) në të dyja qendrat publike dhe private. Në këtë mënyrë Shoqata bashkëpunoi me Qendrën Alternativa Profesionale për çmime më të arsyeshme dhe ia doli mbanë.

### 3.4 Mësimet e nxjerra

#### *Mësimet e nxjerra nga zhvillimi i këtij projekti janë:*

- Për të filluar projekte të tilla duhet të jesh i mirë përgatitur dhe të kesh kurajë të madhe për të përballuar vështirësi dhe jo të dorëzohesh në çdo situatë.
- Përpara fillimit të trajnimit profesional ose të çfarëdo asistence tjetër duhet të luftosh për t'i bërë gratë të vetëdijshme për të luftuar mentalitetin patriarkal dhe kapërcyer paragjykimet. Në këtë mënyrë fitohet më shumë garanci për realizimin me sukses të projektit.
- Ky projekt krijoi hapësira për të hyrë në zonat rurale, por kjo duhet të ndiqet nga hapa të mëtejshëm, nga projekte të tjera që duhet të synojnë shërbimet në komunitet.
- Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë që të përfitohet nga marrëveshjet dypalëshe me institucione dhe ente publike dhe të bashkërendohen shërbimet.
- Të depërtohet më thellë në jetën e komunitetit për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të njerëzve.
- Të inkurajohet ndjekja e kurseve profesionale nga persona që nuk kanë aftësi profesionale për të përballuar tregun e punës në Shqipëri.
- Të përkrahen iniciativat e migrantëve të brendshëm për të filluar një biznes të vogël, megjithëse kjo është një sfidë e vështirë për t'u përballur.
- Të vazhdohet të punohet me gratë si target grup, sepse me to mund të zhvillohen projekte vërtet të mira.



# Hidhe Hapin

Raport vlerësimi për Projektin

